

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA  
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2019**

1. Nxënësi/ nxënësja\* merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Fluturimi i lirë me parashutë (velë)
2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë një përgjigje plotësisht të saktë:

| TEMA                          | NË TEKST? |    |
|-------------------------------|-----------|----|
| Llojet e fluturimeve sportive | PO        | JO |
| Siguria e pilotit             | PO        | JO |
| Lokalitet i përshtatshëm      | PO        | JO |

3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: parashutën e fluturimit me velë (krahun), ulësen dhe sistemin e lidhjes, parashutën rezervë, kapelën mbrojtëse, këpucët mbrojtëse, dorëzat dhe veshjet, pajisjen për ndërlidhje dhe navigim.
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar JO dhe ka shkruar argumentimin: Në tekst thuhet se pa përgatitje cilësore teorike dhe praktike të trajnimit ekzistojnë shanse të mëdha për fatkeqësi./ Trajnimi i gjatë dhe sistematik janë të vetmet mënyra që të përjetohet kënaqësia në lundrim me parashutë .
5. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: pajisja/ frika  
  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Piloti duhet të jetë i pajisur mirë për çdo fluturim sepse fluturimi mund të zgjas shumë./Pajisja e mbron pilotin nga goditjet, të ftohtit, era, rrezatimi UV./Frika është mik i pilotit sepse e pengon që të bëj diçka që në atë moment është jashtë mundësive dhe shkathtësive të tij *(dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar ose perifrastuar fjalinë/fjalitë: Ky sport zhvillohet dhe përhapet në mënyrë intensive gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit dhe merr hov gjithnjë e më shumë në sporte ajrore. Arsyja kryesore është se ky sport nuk kërkon mjete të mëdha financiare. Kjo është një qasje e lehtë dhe e shpejtë e fluturimit të pavarur./ Përparësia e këtij sporti është se nuk ka nevojë për aeroporte ose për çfarëdolloj infrastrukture tjetër të shtrenjtë. Drejtuesi i veles vendos ku dhe kur do të fluturojë. Për aterrimin e një fillestari është i nevojshëm një livadh. Fluturuesve me vela ju mjafton një sipërfaqe që ka diametrin e një gjysmë metri *(dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

7. Është rrethuar numri 3: letrar – **1 pikë**
8. Është rrethuar numri 2: informativ – **1 pikë**
9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përcaktua klasën e fjalëve:  
nuk: *pjesëz (mohuese)*;  
sa: *ndajfolje (sasi)*;  
të vallëzonjësve: *emër*  
shumë: *përemër (i pacaktuar)*
10. Nxënësi merr **2 pikë** për përmirësimin e gabimeve dhe përshkrimin e saktë të fjalisë së dhënë: *Kur të pushojë era ne do të dëshironim të fluturonim me paraglajder.*

Nxënësi merr **1 pikë** për përmirësimin e një gabimit në fjalinë e përshkruar.

11. A) Është rrethuar numri 1: Tana – **1 pikë**
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse argumenton përgjigjen: Tana është personazh i komedisë “14 vjeç dhëndër”, kurse Adham-uti, Zeneli dhe Vurko të “Pas vdekjes”.
12. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: I huaji
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Albert Kamy
13. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Merso/zotëri Merso*
- B) Gjithsej **2 pikë** nxënësi merr **1 pikë** nëse nuk e shpjegon përgjigjen ose nëse përgjigjja bazohet në dallimin, p.sh. rregullisht shkon në punë, ose nëse përgjigjja është plotësisht e plotë por pa stil dhe e paqartë.
- Për një përgjigje të plotë dhe me stil 2 pikë* (P.sh. Përditshmëria jetësore e Mersosë realizohet me shkuarjen e tij në zyre, kryerjen e punëve administrative, kthimin në banesën e tij të vogël dhe të pajisur në mënyrë modeste, me shëtitje të përkohshme, me dalje dhe takime me njerëz me të cilët nuk është i lidhur emocionalisht *(dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
14. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Rrëfim*
15. Gjithsej **2 pikë** - nxënësi merr nga **1 pikë** nëse shkruan saktë titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet personazhi dhe llojin letrar të cilit i përket vepra:

**Dr. Dhadha** - “Doktor Gjilpëra”, roman/prozë - **1 pikë**

**Gjon Zaveri**- “Nga jeta në jetë-pse?!”, roman/prozë - **1 pikë**

16. Është rrethuar numri 3. *Nyje e përparme dhe parafjalë* – **1 pikë**

17. A) Është rrethuar numri 4: gjermane – **1 pikë**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse argumenton përgjigjen: Gjuha malazeze, bullgare dhe maqedonase bëjnë pjesë në gjuhët sllave, kurse gjuha gjermane në gjuhët perëndimore gjermane.

18. A) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. *Iliada* - Homeri
2. *Kanconieri* - Françesko Petrarka
3. *Moti i madh* - Mehmet Kraja
4. *Ylli i Davidit* - Zuvdija Hoxhiq

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Kanconieri/Vepra nën numrin 2.*

19. Është rrethuar numri 1. e *ekzotizmit* – **1 pikë**

20. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Ka trajtë të rrëfimit të lirë.

21. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga **1 pikë** nëse pranë çdo vargu të dhënë ka dalluar figurën stilistike e cila është përdorur në të:

1. apostrofa (**1 pikë**)
2. epiteti (**1 pikë**)
3. metonimia (**1 pikë**)

22. Gjithsej **2 pikë** – nxënësi merr nga **1 pikë** nëse pranë fjalës së dhënë ka shpjeguar kuptimin e saj:

1. tbanat –kasolle barinjsh në stane malësorësh (**1 pikë**)
2. fanar – udhërrëfyes (**1 pikë**)

23. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga **1 pikë** nëse pranë çdo himnizimit ka shkruar vargjet përkatëse nga poema me të cilat himnizohet:

A) Natyra shqiptare: *Agimi lind; me të po çohen brigjet  
E Shqipëris' së rreptë, shkëmb i Sulit,  
Dhe larg të pindit çuka mjegull veshur;*

**1 pikë**

B) Historia shqiptare: *O Shqipëri ku lindi Iskanderi  
Këngë e rinis', fanar i t'urtëve!  
Dhe Iskanderi tjetër, që i dërrmoi  
Përherë armiqt' me Kordhn e tij kreshnike*

**1 pikë**

C) Virtytet shqiptare: Të rreptë bijt' e shqipes! Po vetitë  
nuk u mungojnë; veç t'ishin më të arrira;

**1 pikë**

24. Është rrethuar numri 4. Oregoni – **1 pikë**

25. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: Charl Bodëler dhe Stefan Malarme

**Shënim:** Përgjigjja nuk pranohet nëse nxënësi e përshkruan gabim emrin dhe mbiemrin e shkrimtarit (p.sh. Shar Bodler, Stefan Malame)

26. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përshkruar: romantizmi

27.A) Është rrethuar numri 3: Zhulieta – **1 pikë**

B) Është rrethuar numri 3: Romeut – **1 pikë**

28. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka ndarë saktë të dy fjalët e dhëna në fund të rreshtit: hekurudhë: hekur-udhë/ose he-kurudhë/ ose hekur-u-dhë;  
ekskursion: ek-skursion/ose eks-kursion

29. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar të dy trajtat përfaqësuese të foljeve të dhëna: të kisha rënë – bie; do të kisha ngrënë – ha

30. Skema për vlerësimin e esesë: **Vlladikë Danillo dhe Hamleti personazhe tragjike**

|                                     |  |
|-------------------------------------|--|
| <p><b>Kërkesa</b><br/><b>1.</b></p> | <p>Nxënësi cek gjinitë letrare të cilave u përkasin veprat: <i>Hamleti</i> – dramës (<b>1 pikë</b>); <i>Kurora e maleve</i> - epikës (<b>1 pikë</b>)</p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>   |
| <p><b>Kërkesa</b><br/><b>2.</b></p> | <p>Nxënësi përshkruan për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlladikën Danillo dhe thekson: <ul style="list-style-type: none"> <li>- tiparet e tij të karakterit (tregon për tiparet e karakterit të tij – <b>1 pikë</b>, për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>)</li> <li>- raportin e tij ndaj personazheve tjerë (përmend personazhet dhe raportet ndaj tyre – <b>1 pikë</b>, për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>)</li> </ul> </li> <li>- Hamletin dhe thekson: <ul style="list-style-type: none"> <li>- tiparet e tij të karakterit (tregon për tiparet e karakterit të tij</li> </ul> </li> </ul> |

|                   |   |
|-------------------|---|
|                   | <p>– <b>1 pikë</b>, për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>)</p> <p>- raportin e tij ndaj personazheve tjerë (përmend personazhet dhe raportet ndaj tyre – <b>1 pikë</b>, për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>)</p> <p>- fundin i tij (tregon për vdekjen e tij – <b>1 pikë</b>, për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>)</p> <p><b>Gjithsej 10 pikë</b></p> |
| <b>Kërkesa 3.</b> | <p>Nxënësi shpjegon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përse Vlladika Danillo është personazh tragjik (<b>1 pikë</b>)</li> <li>- përse Hamleti është personazh tragjik (<b>1 pikë</b>)</li> </ul> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil <b>1 pikë</b>.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>   |

### Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku  | Saktësia gjuhësore   | Lidhshmëria  | Struktura ndërtimore e tekstit  |
|--|--|--|---|
| <p>Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil.</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në</p> | <p>Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, foljet përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali,</p> | <p>Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët).</p> <p><b>2 pikë</b></p> |
| <p>renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me</p>   |  |  |   |

|   |  |  |   |
|---|--|--|---|
| <p>ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale.</p> <p><b>2 pikë</b></p> | <p>gabime minimale.</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <i>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</i>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <i>ë</i>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>).</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> |  |   |
| <p>Përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.</p> <p><b>1 pikë</b></p>         | <p>Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <i>për</i> dhe <i>mbi</i>, përemrit <i>i vet/ i tij</i>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <i>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</i> dhe i përemrave: <i>që, i cili, e cila, të cilët</i> etj.).</p>   |  | <p>Ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.</p> <p><b>1 pikë</b></p> |

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>Respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>).</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |  |  |
|--|--|--|--|

**Skema për vlerësimin e esesë: Dallimi në mes të brezave**

|                   |   |
|-------------------|---|
| <b>Kërkesa 1.</b> | <p>Nxënësi shpreh shkurt mendimin e vet për dallimin në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p>Nxënësi shpreh në formë më të plotë mendimin e vet për dallimin në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>                     |
| <b>Kërkesa 2.</b> | <p>Nxënësi përmend përse bashkëmoshatarët e tij “bien” në konflikte me të moshuarit. <b>(1 pikë)</b></p> <p>Nxënësi shpjegon përse bashkëmoshatarët e tij “bien” shpesh në konflikte me të moshuarit. <b>(1 pikë)</b></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p> |
| <b>Kërkesa 3.</b> | <p>Nxënësi aprovon ose konteston programin eksperimental në Amerikë lidhur me dallimin në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p>   |

|                   |  |
|-------------------|--|
|                   | <p>Nxënësi kumton më gjerësisht qëndrimin e vet për eksperimentin në fjalë. <b>(1 pikë)</b></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>  |
| <b>Kërkesa 4.</b> | <p>Nxënësi përmend shkurtimisht gatishmërinë/mosgatishmërinë që të kapërcehet dallimi në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p>Nxënësi shpjegon nëse është i gatshëm ose jo për kompromis në mënyrë që të tejkalohet dallimi në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p> |
| <b>Kërkesa 5.</b> | <p>Nxënësi kumton propozimin e vet për kapërcimin e dallimit ndërmjet brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p>Nxënësi kumton dhe argumenton propozimin e vet për kapërcimin e dallimit në mes të brezave. <b>(1 pikë)</b></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>  |

### Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku   | Saktësia gjuhësore  | Lidhshmëria  | Struktura ndërtimore e tekstit   |
|---|---|--|--|
| <p>Origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë</p> | <p>Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të</p> | <p>Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda</p> |



|   |  |  |   |
|---|--|--|---|
| <p>dhe e saktë, fjalitë me stil.</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale.</p> <p><b>2 pikë</b></p> | <p>tipit: <i>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</i> dhe i përemrave: <i>që, i cili, e cila, të cilët</i> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <i>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</i>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <i>ë</i>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>).</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> |  | <p>shtjellimit ndan paragrafët).</p> <p><b>2 pikë</b></p> |
| <p>Përsëritja e fjalëve dhe e</p>   | <p>Respektimi i normës gramatikore me gabime</p>   |  | <p>Ndan qartë hyrjen,</p>                                 |

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
| <p>shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.).</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>).</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |  | <p>shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.</p> <p><b>1 pikë</b></p> |
|--|--|--|--|